



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

Nr. ____ prot

Dt. ____/____/2025

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: **BLERJE KARBURANTI DIEZEL**

- Fondi limit **10 000 000 (Dhjetë milionë) Lekë , pa TVSH**

-Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë

Lloji procedurës së prokurimit të jetë : **E Hapur**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Nga lidhja e kontratës deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të kontratës..

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia TROPOJE** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Sipas kriterëve të përgjithshme të perzierjes/kualifikimit, Shtojca 8.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022,2023,2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës** së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- *Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet e sipër përmendura.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur

janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së..

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme i referohet zbatimit të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës **ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklarura në organet tatimore** ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”... *vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

2.3.2 Subjekti Kontraktues duhet që të ketë pike të licencuar furnizimi në Qytetin e Tropojës.

- Stacioni i tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur:
 - Autorizim lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë,
 - Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL,
 - Çertifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH,

2.3.3 Subjekti ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku minimumi të ketë stacione në aksin Tropoje, Kukës, Has, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate qeraje ose akt pronësie ose të jete të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregëtar lëshuar nga QKB). Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur me Autorizim/Licence lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë, leje mjedisore të tipit B Vërtetim teknik të lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlersimit të Konfirmimit (OMVK), Çertifikat e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmeri së datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të*

kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” nenit 40, pika 5, germa a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.4 Subjekti ekonomik që shpallet fitues ,duhet që të sigurojë dhe garantojë furnizimin me karta elektronike të personalizuar ,të cilat mundësojnë identifikimin e targës së makinave /automjeteve dhe përdoruesin e saj.

2.3.5 Ofertuesi /subjekti ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin 24 orë në çdo ditë të javës , deri në përfundim të kontratës, të furnizimit të plotë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter shërben për të treguar se ofertuesit i kanë kapacitetet teknike lidhur me ekzekutimin e kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e cilesisë së shërbimit **ISO 9001- 2015 Ose Ekuivalente** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e **ISO 14001: 2015 O Ose Ekuivalente** me të, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit. *vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente) (të vlefshme),në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes të zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes

- **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh

kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimi i Materialeve:

Substanca	Njësia matëse	Limitet (normat)		Metoda e provës
		Minimum	Maksimumi	
Numri i Cetanit		51	-	EN ISO 5165 EN 15195 EN 16144
Indeksi Cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 gradë celsius	Kg/m ³	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarbure Polycyclic aromatike	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtje squfuri	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884 EN ISO 13032
Përmbajtje Mangani Deri 31-12-2013 Nga 01.01.2014 në vazhdim	mg/l	- -	6,0 2,0	Pr EN 16576
Pika e ndezjes	Gradë celsius	Mbi 55	-	EN ISO 2719
Karboni i mbetur (në 10%mbetje distilati)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Kontaminimi total	mg/kg	-	24	EN 12662
Gërryerja e shiritit bakrit (3 orë në 50 gradë celsius)	Grada	Grupi 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e Acidit të ngopur metil ester	% (V/V)	-	7,0	EN 14078

FAME				
Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m ³ h	- 20	25 -	EN ISO 12205 EN 15751
Lubrifikimi, diametri i veshjes së mprehte (ësd 1,4) në 60 gradë Celsius	µm (micrometer)	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 gradë Celsius	Mm ² /s	2,000	4,500	EN ISO 3104
Distilimi % (V/V) rafinimi në 250 gradë celsius % (V/V) rafinimi në 300 gradë Celsius 95 % (V/V) rafinimi në	% (V/V) % (V/V) Gradë celsius	85	Më pak se 65 360	EN ISO 3405 EN ISO 3924
a. Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklikë aromatikë janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se përmbajtja e hidrokarboneve mono-aromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916. b. Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për prezencën e FAME, nën mbikëqyrjen e CEN. c. FAME i përkojnë kërkesat e EN 14214, shih (3). d. Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2 % (V/V) FAME , qëndrueshmëria e oksidimit e përcaktuar në EN 15751 është kërkesa për të. e. Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50 % dhe 90% (V/V) nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY. f. Limitet e distilimit në 250 gradë Celsius dhe 350 gradë Celsius janë përfshirë në tarifën e karburantit naftë të Doganave të përbashkëta të BE. g. EN ISO 3924 jep instruksione për konvertimin në ISO 3405-të dhëna ekuivalente. Shih gjithashtu 5.7.5.				

• **Afatet e lëvrimit:**

Nga lidhja e kontratës deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të kontratës..

Njesia e prokurimit
